



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-klina.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



Duke u Mbështetur në nenin 40.2 nën c) të LVL nr. 03/L-040 nenit 40 al2 nën pikën 3 të Statutit të Komunës së Klinës dhe rekomandimet e KPF-së, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VIII-të të radhës për vitin 2015, të mbajtur më 25.09.2015, mori këtë:

V E N D I M

Për

Miratim të Raportit të menaxhimit financiar komunal për periudhën janar-qershor 2015

I

Miratohet Raporti i menaxhimit financiar komunal për periudhën janar-qershor 2015.

II

Buxheti në SIMFK sipas burimit dhe buxheti i shpenzuar për janar – qershor 2015 ishte sa vijon:

Buxheti i shpenzuar në periudhën janar-qershor 2015 në vlerë 4,236,244.38 € është 48.44 % e buxhetit në SIMFK për 2015. Nga Granti qeveritar 3,755,206.96 € (50.15 % në raport me buxhetin nga granti), nga të hyrat vetanake 192,943.59 € (22.49 % në raport me buxhetin nga të hyrat për 2015), nga të hyrat e bartura 288,093.83 € (78.60% në raport me buxhetin nga të hyrat e bartura). Ndërsa nga totali i buxhetit të shpenzuar në këtë periudhë në vlerë 4,236,244.38 € nga Granti qeveritar janë 88.64%, nga të hyrat vetanake 4.56 % dhe nga të hyrat e bartura 6.8 %. Shpenzimet e buxhetit në këtë periudhë janë më të larta për rreth 9.12 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

III

Shpenzimet e buxhetit sipas kategorive ekonomike për periudhën janar-qershor ishte:

Nga buxheti i shpenzuar në periudhën janar – qershor 2015 në vlerë 4,236,244.38 € për paga dhe mëditje janë shpenzuar 2,737,804.17 € (64.62% e shpenzimeve), për mallra dhe shërbime janë shpenzuar 362,474.61 € (8.55% e shpenzimeve), për shërbime komunale 103,768.69 € (2.44% e shpenzimeve), për subvencione 53,201.95 € (1.26 % e shpenzimeve) dhe për kapitale 978,994.96 € (23.11 % e shpenzimeve).

Shpenzimet në periudhën janar-qershor 2015 në vlerë 4,236,244.38 € krahasuar me shpenzimet për periudhën e njëjtë të vitit 2014 në vlerë 3,882,281.78 € janë rritur, rreth 9.12 %. Shpenzimet për paga dhe mëditje krahasuar me vitin paraprak janë rritur 13.06 %, shpenzimet për mallra dhe shërbime janë rritur për 2.53 %, shpenzimet për shërbime komunale janë rritur për 25.47 %, shpenzimet për subvencione janë zvogëluar për 7.79 % dhe shpenzimet për kapitale janë rritur për 1.24 %.

IV

Raporti si në pikën 1 të këtij Vendimi miratohet me vërejtjet dhe sugjerimet që janë të përfshira në procesverbalin e Kuvendit të Komunës të mbajtur po në ditën e miratimit me dt.25.09.2015.

V

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Klinës, ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas pranimit të tij nga autoriteti mbikëqyrës për shqyrtimin e ligjshmërisë, konform nenit 81 të LVL.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr 06-5364 2015
Klinë, më 25.05.2015



KRYESUESI,
Dr. Haxhi Ibishi